

AKT – THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“3D-COMPANY ” Sh.p.k.

Në Korce sot më datë 28 Janar 2014, ortaket e shoqërisë “3D - Company” SH.P.K., Xhezar OSMAN, i datëlindjes 08.03/1955, lindur në Dersnik , Korce dhe banuese në Korçë, mbajtëse e kartës së identitetit NR Personal F50308059F vendosA të themelojnë këtë Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të nënshkruajnë Statutin dhe këtë Akt – Themelimi si në vijim:

Neni 1 – Forma


- 1.1. Shoqëria “3D - Company” SH.P.K., (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti të Themelimit dhe Statutit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është “3D - Company” SH.P.K.,
- 2.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare dhe shërbime në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2. Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë :



Dizinfektimi, deratizimi dhe dizinsektimi ambjentesh biznesi, institucione, shtëpi, farmaci bujqësore, import-eksport, tregu i artikulave të ndryshëm, shërbime dhe furnizime institucione publike, shërbime ndërtimi, tregu i materialeve ndërtimi dhe të ndryshme etj.

- 3.3. Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, me individë, shoqëri tregëtare, ente publike apo private, në lidhje me aktivitetin e saj bazë, siç citohet në pikën 3.2 të Aktit të Themelimit. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: L 9 Rruga KICO GRECO , Korce Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6 – Kapitali themeltar dhe ortaku i vetëm

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë lekë).
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind) kuota, të gjitha të nënshkuara dhe të shlyera, me vlerë nominale 1.000 (njëmijë lekë) secila.
- 6.3. Z. Xhezar OSMAN , datëlindjes 08.03.1955, lindur në Dersnik, Korce dhe banuese në Korçë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. F 50308059F
- 6.4. Përgjegjësia e ortakëve shtrihen deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 7 – Transferimi i kuotave



- 7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 7.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.
- 7.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 7.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 7.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.
- 7.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 8 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj

- 8.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 8.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 9 – Administrimi

- 9.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të veprojnë si veçmas ashtu edhe bashkërisht. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim
- 

apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh dhe janë të rizgjedhshëm. Në rast se Asambleja nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë të Administratorëve, mandati i këtyre të fundit do të rinovohet automatikisht sipas afatit të përcaktuar në këtë Statut.

- 9.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë u besohet Administratorëve. Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha fuqitë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 9.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 9.4 Administratori i parë i Shoqërisë është z. Xhezar QSMAN, i datëlindjes 08/03/1955, lindur në Dersnik , Korce dhe banuese në Korçë, mbajtës i kartës së identitetit nr.personal F50308059F është ortaku i vetëm i Shoqërisë, e cila do të qëndrojë në detyrë deri në përzgjedhjen e administratorit të ri nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.
- 9.5 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve me nënshkrimin e administratorit.
- 9.6 Administratori i Shoqërisë administron veprimtarinë e shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë, merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave, përgatit dhe nënshkruan pasqyrat vjetore financiare dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe i dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve në Asamblenë e Përgjithshme për miratim, krijon sistemin e paralajmërimit në lidhje me rrethanat të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë, dorëzon në QKR dokumentat dhe të dhënat e Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, raporton në Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë, kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky statut, është i autorizuar për të siguruar mjetet financiare dhe kredi, të lidhë marrëveshje përkatëse me banka, institucione krediti ose financiare vëndase ose të huaja, duke përdorur si mjete garancie në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi asetet e Shoqërisë.

Neni 10 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 10.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 10.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 10.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe të ekspertit kontabël të



autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga ligji 9901 me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- 10.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"3D-COMPANY " Sh.p.k.

Xhezar OSMAN

